

Republika e Shqiperise  
Gjykata Administrative e Shkalles se Pare  
KORÇE

Nr 536-00626 Regj.Them  
Data e regj 27.04.2016

Nr 1201-(481) Vendimi  
Data 18.10.2016

**V E N D I M**  
**“Ne emer te Republikes”**

Gjykata administrative e shkalles se pare Korçe e perbere prej:

Kryetare e seances gjyqesore - **ETLEVA GJAMO**

asistuar nga sekretare e seances gjyqesore Safjola Sadik ne Gjykate, ne date 18.10.2016, ora 15 30 mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura çeshtjen administrative me nr 536-00626 rregjistri themeltar , date 27.04.2016 rregjistrimi qe i perket:

**PADITES:** **Subjekti tatimpagues “Lindita Pelivani”**, njohur si person fizik nga ligji shqiptar, me NIPT L03901002T , adresa Lagja nr 8, Ruga “Naum Kristo Voskopoja”, nr 12, perfaqesuar me prokure te dhene gjate gjykimit nga av Ermir Petriti i Dhomes se Avokatise Korçe.

**E PADITUR:** **Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe**, perfaqesuar me autorizim nga juriste Mirela Veriga.

**OBJEKTI:** ”Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ ,Akt njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr 20 697 prot date 30.12.2015 të DRT Korçe si një akt administrativ relativisht i pavlefshëm dhe anulimin e gjobave në vlerën gjithësej 60 000 leke

**Baza Ligjore:** Neni 42 i Kushtetutes se R.Sh, neni 109/2,112, 119/1/b i ligjit ne.9920 date 19.05.2008 „Per procedurat tatimore „ i ndryshuar, Udhezimi nr.24 date 02.09.2008 „Per procedurat tatimore“ nenet 7/a,11/1,15/a,16 pika 1 dhe 17 pika 1/a te ligjit nr.49/2012 neni 115/b dhe 118 te K.Pr.Administrative.

Ne perfundim te gjykimit te zhvilluar ne prani te perfaqesuesit me prokure te paditeses dhe ne prani te perfaqesueses me autorizim te pales se paditur, ne pretendimet perfundimtare te depozituara me shkrim, paditesja ka kerkuar pranimin e padise, perfaqesuesja e pales se paditur kerkoj rezimin e padise.

Gjykata pasi shqyrtoi aktet dhe bisedoi çeshtjen ne teresi.

**V E R E N**

Nga aktet bashkangjitur kerkese padise ka rezultuar se paditesja Lindita Pelivani eshte rregjistruar si person fizik prrej vitit 2010 si biznes i vogel me objekt te veprimtarise "Tregeti me pakice artikuj ushqimore dhe me mjet".

Ne daten 26.09.2015 nga Inspektoret e Verifikimit ne Teren te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe eshte ushtruar kontroll ne mjetin me targe KO 4924 B, drejtuar nga shtetasi Gerti Labi, dhe eshte mbajtur "Akti konstatimi" ku eshte evidentuar fakti se..... subjekti Lindita Pelivani eshte i regjistruar ne QKR dhe u gjend duke transportuar mall me mjet, i papajisur me adrese dytesore per mjetin e tij. Mjeti drejtohet nga shtetasi Gerti Labi identifikuar me karte identiteti. Malli eshte i pashoqeruar me dokument tatimor dhe si rezultat kryehet konfiskimi tij .

Mbi te dhenat e aktit te konstatimit, ne daten 26.09.2015 eshte mbajtur "Procesverbal gjobe" dhe ne baze te nenit 112 te ligjit nr 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", subjekti eshte denuar me gjobe ne masen 10 000 leke, per mosperditesim te te dhenave per adresen dytesore ne ambientet e mjetit tip Benz me targe KO 4924 B.

Po keshtu ne daten 26.09.2015 eshte mbajtur "Procesverbal gjobe" dhe ne baze te nenit 119, pika 1, germa b) te ligjit nr 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", subjekti eshte denuar me gjobe ne masen 50 000 leke, pasi nuk ka deklaruar ne skemen e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore punonjesin Gerti Labi.

Akti i konstatimit rezulton te jete nenshkruar nga drejtuesi i mjetit Gerti Labi , ndersa "Procesverbalet e gjobes" permbajne shenimin se perfaqesuesi i tatimpaguesit ka refuzuar te firmose.

Ne daten 28.12.2015 Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe ka nxjere "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore ku personit fizik Lindita Pelivani i kerkohet pagesa e gjobes prrej 60 000 leke, i cili i ehste njoftuar subjektit me shkresen nr 20 697 prot date 30.12.2015.

Paditesja nuk ka qene dakord me "Njoftim vleresimin e detyrimit tatimor -gjobe" dhe ka paraqitur ankim ne Drejtorine e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane.

Kjo e fundit me vendimin nr 2750/1 date 29.03.2016 ka rezuar ankimin duke lene ne fuqi Njoftim vleresimin per detyrimet tatimore te DRT Korçe.

Ne daten 27.04.2016 paditesja ka paraqitur ne gjykate padine objekt i ketij gjykimi me te cilen kerkon "Shfuqizimin e njoftim vleresimit per detyrimet tatimore".

Lidhur me kerkimin per Shfuqizimin e aktit administrativ , si ne padi dhe gjate gjykimit, paditesja konteston "Njoftim vleresimin tatimor" pasi nga ana e inspektoreve tatimore ne ushtrimin e kontrollit nuk jane respektuar kerkesat e ligjit "Per procedurat tatimore" pasi inspektoret qe kane kryer kontrollin kane qene ne periudhe prove dhe nuk polotesonin krieteret minimale te ligjit 10 433 date 16.06.2011 "Per inspektimin ne Republiken e Shqiperise", çka perben dhe shkakun kryesor te hartimit te akteve ne kundershtrim me "Manualin e verifikimit ne teren".

Inspektoret e DRT Korçe nuk e kane kryer kontrollin ne ambientet ku paditesja ushtron aktivitetin tregetar, por ne nje mjet ne fshatin Vreshtas dhe paditesja nuk mund te mbaje pergjegjesi per mallra qe mbahen apo tregetohen jashte ambienteve te saj dhe nese eshte konstatuar mall pa fature duhet te ishte penalizuar drejtuesi i mjetit. Pretendimi i pales se paditur se ne momentin e kontrollit paditesja nuk ka patur te deklaruar ne skemen e sigurimeve shoqerore drejtuesin e mjetit nuk qendron pasi drejtues mjeti i subjektit ka qene

shtetsi Kleanti Seit , ndersa shtetasi Gerti Labi eshte nje i aferm i bashkeshortit te paditeses i cili nuk ka patur asnje lidhje me subjektin tatimpagues dhe rjedhimisht paditesja nuk ka kryer shkelj te parashikuar ne nenin 119, pika 1 , germa b) te ligjit 9920 date 19.05.2008.

Lidhur me shkeljen e nenit 112 te ligjit, eshte nje konstatim i gabuar pasi automjeti i kontrolluar nga DRT Korçe nuk eshte ne pronesi te paditeses por ne bashkeproneisi te bashkeshortit te saj dhe vellait te tij dhe nuk perdoret per qellime biznesi, por per aresye familiare.

Referuar sa me siper ne kushtet kur paditesja nuk ka kryer shkelje tatimore, duhet te shfuqizohet njoftim vleresimi per detyrimet tatimore si akt relativisht i pavlefshem.

**Perfaqesuesja e pales se paditur** Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe gjate gjykimit, prapesoi se ne momentin e ushtrimit te kontrollit tatimor gjendja e konstatuar u pasqyrua ne aktin e konstatimit lidhur me faktin se shtetasi Gerti Labi ne cilesine drejtuesit te mjetit punonte per llogari te subjektit Lindita Pelivani .Nga kontrolli rezultoi se mallrat e gjetura ne mjetin e transportit nuk ishin te shoqeruara me fature tatimore dhe per kete aresye u vendos konfiskimi ne perputhje me nenin 121 te ligjit 9920 date 19.05.2008 .

Ne baze te nenit 80.3 te ligjit 9920 date 19.05.2008 dhe Udhezimit nr 24 date 02.09.2008 Inspektoret e verifikimit ne teren kryejne verifikime ne vendin e ushtrimit te aktivitetit me qellim zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje me veprimtarine e tatimpaguesit dhe akti i konstatimit eshte mbajtur ne zbatim korekt te ligjit 9920 date 19.05.2008 si dhe ligjit nr 10 279 date 20.05.2010 “Per kundravajtjet administrative”. Tatimpaguesi ka shkelur norma ligjore pasi nga Inspektoret e DRT u konstatua kundravajtja administrative e parashikuar nga nenet 119.1b, 121 dhe 112 te ligjit 9920 date 19.05.2008 duke u vendosur masat perkatese.Pretendimi i pales paditese se drejtuesi i mjetit ishte i aferm i families dhe se ne momentin e kontrollit ka qene per punet personale, eshte i pabazuar pasi nga verifikimi i te dhenave ne sistemin informatik, ai eshte deklaruar nje dite pas ushtrimit te kontrollit ne skemën e sigurimeve shoqerore.Ne piken 40.4 te Udhezimit nr 24 date 02.09.2008 parashikohet pajisja me certifikata regjistrimi per cdo adrese ku subjekti ushtron veprimtarine e tij ekonomike dhe tregtare dhe persa me siper eshte vendosur denimi me gjobe ne baze te nenit 112 te ligjit per mosperditesim te te dhenave lidhur me adresën e veprimtarise , mjetin ku eshte ushtruar kontrolli.

**Gjykata pasi shqyrtoi pretendimet e paditeses , prapesimet e pales se paditur si dhe provat e sjella prrej tyre, bazuar edhe ne percaktimet e nenit 16 te Kodit te Procedures Civile ne lidhje edhe me nenin 17/2 te ligjit 49/2012 çmon se padia e paditeses eshte e pabazuar ne ligj dhe ne prova dhe si e tille duhet te rezohet**

Paditesja e bazon padine e saj ne dispozita te ligjit te posaçem “Per procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise” si dhe ne Kodin e Procedurave Administrative duke kerkuar anullimin/shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vleresimit tatimor, i cili eshte akt administrativ me karakter individual qe prek drejtperdrejt te drejta te personit fizik ne cilesine e tatimpaguesit .

Nga teresia e provave te shqyrtuara gjate gjykimit, gjykata konkludon se ne kundërshtim me sa pretendon paditësja kemi te bejme me nje akt te velfshem , per shkak se organi administrativ qe e kane nxjere ate e ka vleresuar situaten faktike qe legjislacioni tatimor e kerkon si kusht per penalizim te subjektit, dhe nuk eshte konkluduar apriori se eshte kryer shkelje tatimore administrative.

Ne kete aspekt nuk ndodhemi para mungeses se provimit te elementeve materiale, te cilet jane vendosur ne themel te njoftim velresimit dhe akteve qe e paraprijne ate , me qellim qe do konkludohet per pavlefshmeri te aktit.

Ne kete konkluzion gjykata arrin pas nje analize te hollesishme te dokumentacionit mbi bazen e te cilit eshte konkluduar per konsumim te elementeve te kundravajtjeve tatimore administrative, e mandej eshte vendosur penalizimi me gjobe.

Keshtu **neni 80.3.c**, i Udhezimit 24 date 02.09.2008 "Per procedurat Tatimore" , e parashikon verifikimin ne vend si nje nga llojet e kontroleve tatimore qe ne vetvete eshte nje verifikim i shkurter qe synon zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje nder te tjera edhe .....me perdorimin e pajisjeve fiskale, perditesimin e te dhenave te subjeteve, deklarimin e te punesuarve rishitas ne skemem e sigurimeve shoqerore etj.....

Po keshtu, kjo pike e Udhezimit parashikon se keto verifikime kryhen pa njoftim paraprak te personave te tatueshem por vetem nepermjet prezantimit ne momentin e verifikimit te dokumentit personal te verifikuesit dhe urdherin e dites te leshuar nga Drejtuesi i Drejtorise se kontrollit per verifikime ne vend.

Ne rastin konkret sipas te dhenave te cituara ne aktin e konstatimit provohet se ndodhemi para nje kontrolli te tille te ushtruar ne baze te urdherit te punes date 22.09.2015 cituar ne aktin e konstatimit nga Inspektore te Drejtorise Rajonale Tatimore.

Pretendimi i pales paditese se Inspektoret e Verifikimit ne teren nuk plotesonin kriteret ligjore per te ushtruar kontroll dhe per te mbajtur aktet perkatese eshte nje pretendim i pabazuar ne ligj pasi nuk u soll asnje prove per te provuar qe ata te mos kene qene inspektore me te drejta kontrolli apo te kene vepruar jashte detyrave te percaktuara ne urdherin e punes.

Sa i takon pretendimit te paditesit bazuar ne ligjin 10 433 date 16.06.2011 'Per inspektimin' gjykata ne referim te nenit 2, pika c) te tij evidenton faktin se kontrolli tatimor dhe doganor perjashtohet nga fusha e zbatimit te ketij ligji dhe ai nuk mund te perbeje reference per ceshtjen objekt gjykimi.

Persa i takon shkeljeve te konstatuara, Gjykata vlereson se akti i konstatimit ploteson kushtet ligjore pasi ne te jane evidentuar gjetjet e konstatura , pra fakti qe mjeti drejtohej nga shtetasi Gerti Labi i cili eshte personi qe ka deklaruar identitetin e tij dhe ka informuar inspektoret se punonte per llogari te subjektit Lindita Pelivani dhe se malli i gjetur ne mjetin qe drejtohej prej tij i perkiste ketij subjekti.

Pala paditese gjate gjykimit kerkoi pyetjen e shtetasit Gerti Labi ne cilesine deshmitarit per te provuar faktin se ne kohen e mbajtjes se aktit te konstatimit ai ndodhej per shkak te lidhjeve familiare dhe jo si i punësuar, por gjykata nuk e pranoi kerkesen pasi vleresoi se akti i konstatimit perben prove te plote persa permbahet ne dhe mund te kundërshtohet vetem per falsitet, pasi eshte mbajtur nga punonjesit e DRT Korçe, brenda kopetencave te parashikuara me ligj, eshte nenshkruar nga personi i kontrolluar i cili ka dhene identitetin e tij dhe ka dhene informacion per faktet e konstatuara. Ne kete aspekt ne vështrim te nenit 232 e vijues te Kodit te Procedurave Civile nuk lejohet prova me deshmitare te permbajtjes se nje akti me fuqi te plote provuese.

Nga shqyrtimi i te dhenave te sistemit informatik ka rezultuar se shtetasi Gerti Labi nuk ka qene i deklaruar nga subjekti tatimpagues ne skemën e sigurimeve shoqerore ne perputhje me afatet kohore te parashikuara nga neni 119 i ligjit 9920 date 19.05.2008 dhe me te drejte eshte vendosur penalizimi me gjobe sipas nenit 119, pika 1 , germa b) e ketij

ligji. Nga ana tjetër vete subjekti ka bërë deklarinimin e tij të nesërmen e mbajtjes së aktit të kontrollit, duke ligjeruar situatën faktike të konstatuar një ditë më parë.

Po kështu me të drejtë është vendosur penalizimi me gjobe në masën 10 000 leke bazuar në nenin 112 të ligjit 9920 datë 19.05.2008 pasi paditesja nuk ka respektuar detyrimin për "regjistrim apo perditesim të të dhënave", në lidhje edhe me percaktimet e pikave 40.4 dhe 41.1.1 të Udhezimit nr 24. Paditesja është konstatuar se ushtronte aktivitet tregëtar në mjet, nderkohe që nuk e patur të deklaruar këto adrese dyesore dhe nuk ka qenë e pajisur me certifikate.

Nderkohe rezultoi se edhe mjetin ku është ushtruar kontrolli të këtyre deklaruar si adrese dyesore të ushtrimit të veprimtarisë pas mbajtjes së aktit të konstatimit.

Në këtë aspekt veprimet e palës paditëse të kryera pas datës së ushtrimit të kontrollit nuk përfaqësojnë gjë tjetër veçës regullim të situatës së konstatuar nga inspektorët në shkelje të ligjit.

Në analizë të sa më sipër çmohet rezimi i padisë pasi pala e paditur ariti të provoje ligjshmerinë e aktit administrativ të nxjerrë prej saj dhe faktet që ka vendosur në themel të vendimarrjes.

Në veshtrim të nenit 45 germa a) të ligjit 49/2012 ky vendim është i paankimueshem pasi sipas kësaj dispozite.... *nuk lejohet ankimi ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt kundërshtimin e denimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative me vlerë me të vogël se 20-fishi i pages minimale në shkallë vendi.* Në bazë të VKM nr. 573, datë 3.7.2013, "Për percaktimin e pages minimale në shkallë vendi", duke filluar nga muaji Korrik 2013 e në vazhdim, paga bazë minimale mujore, për punonjësit në shkallë vendi, është 22.000 ( njëzet e dy mijë ) leke.

Lidhur me shpenzimet gjyqësore të takses mbi aktet në shumën 3 000 leke të parapaguara nga pala paditëse, konform nenit 106/1 të K.Pr.C mbeten në nagrkim të paditeses meqenese çmohet rezimi i padisë.

### PER KETO ARESYE

Gjykata bazuar në nenin 40-43 dhe 45, a) të ligjit 49/2012 si dhe 118 të Kodit të Procedurave Administrative

### VENDOSA

Rezimin e padisë së paditëses Lindita Pelivani, pale e paditur DRT Korçë, me objekt "Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ, Akt njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr 20 697 prot date 30.12.2015 të DRT Korçë si një akt administrativ relativisht i pavlefshëm dhe anulimin e gjobave në vlerën gjithësej 60 000 leke" si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Shpenzimet gjyqësore në shumën 3 000 leke i ngarkohen palës paditëse.  
Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk lejohet ankimi.

Ushpall në Korçë date 18.10.2016

Sekretare  
Safjola Sadik



G J Y Q T A R E  
ETLEVA GJAMO

